REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRISË-MINISTARSTVO TRGOVINE I INDUSTRIJE-MINISTRY OF TRADE AND INDUSTRY

Njësia Org. / Org. Jedinica / Org.Unit: 01 — Nr.Prot. / Broj.Prot. / Prot.No: 1613
Nr. i faqeve / Broj.stranica / Nu.pages: 1 — Data / Datum / Date: 27.03.2020
Prishtinë / q

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova / Republic of Kosovo
*Qeveria – Vlada – Government*

Ministria e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike
Ministarstvo Ekonomije, Zapošljavanja, Trgovine, Industrije, Preduzetništva i Strateških Ulaganja
Ministry of Economy, Employment, Trade, Industry, Entrepreneurship and Strategic Investments

---

Nr. ref. **01/06**
Prishtinë, 26.03.2020

Ministrja e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike, mbështetur në nenin 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, lidhur me Ligjin nr. 05/L-031 të Procedurës së Përgjithshme Administrative dhe Ligjin nr. 2004/5 për Tregtinë me Naftë dhe Derivate të Naftës në Kosovë, i ndryshuar me ligjet nr. 02/L-89 dhe nr. 03/L-138, nenin 8.1.4 dhe shtojcën 8 të Rregullores (QRK) nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive dhe vendimet nr. 01/09 të 13 marsit 2020 dhe nr. 1/11 të 15 marsit 2020 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, dhe duke pasur parasysh emergjencës e shëndetit publik si pasojë e pandemisë së koronavirusit dhe me qëllim të lehtësimit të punës së operatorëve ekonomikë në sektorin e naftës, nxjerr këtë:

**URDHËRESË**

1. **Pezullohet** shqyrtimi i kërkesave për licencim për tregti me naftë dhe derivate të naftës nga 27 mars deri më 26 maj 2020.
2. Detyrohen të zbatojnë këtë urdhëresë Departamenti i Rregullimit të Tregut të Naftës dhe operatorët ekonomikë në sektorin e naftës.
3. Kjo urdhëresë hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Rozeta HAJDARI**

Ministre në detyrë

*U dërgohet:*

- Zyrës së Kryeministrit
- Ministrit të Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë
- Departamentit të Rregullimit të Tregut të Naftës
- Departamentit Ligjor të Ministrisë
- Arkivit të Ministrisë